3	Aparatura për matjen e temperaturave të kontakteve dhe analizën me imazh termik të auto dhe transformatorëve dhe pikave të nxehta në pajisjet e tjera primare.	Komplet	1			
4	Trajnim për specialistët e DSHMT për pajisjet e reja për matje pajisjesh primare dhe sekondare. Grupe pune 2 (dy), sejcili grup pune nga 4 punonjës dhe 4 ditë pune trajnim.	Komplet	1			
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>						_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						
<b>Vula</b>						
<b>Datë</b> _____						

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**



## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### **1. Aparaturë komplete multifunksionale për matjen e auto dhe transformatorëve të fuqisë trefazor e pajisur edhe me transformator tensionin për teste në tension të rritur.**

Qëllimi bazë i kësaj aparature komplete multifunksionale është që të sigurojë tesimet bazë të parametrave kryesorë të autove dhe transformatorëve trefazor njëkohësisht në të treja fazët e këtyre pajisjeve transformuese të tensionit dhe rrymës, duke siguruar këto përparësi kryesore:

- Me një konfigurim të skemës së lidhjes së kabllave të aparaturës me pajisjen që do të testohet, auto apo transformator, të kryhen disa teste kryesore, pa pasur nevojën e ndryshimeve në të (skemës);
- Shkurtim deri në tre herë të kohës totale të testeve, në krahasim me matjet me aparatura që kryen teste një fazore, duke mos përfshirë këtu edhe kohën që do të nevojitet për realizimin e skemës së matjeve nga njëra fazë në tjetrën;
- Rritjen e sigurisë së punës të personelit që kryen testimin gjatë kohës së kryerjes së tyre, duke mos pasur nevojë, ndër të tjera, për të kryer ndryshime të skemës së matjeve në lartësi disa herë, duke pasur parasysh që auto dhe transformatorët e OST sh.a. janë me fuqi deri në 345 MVA, tensione të larta deri në 400 kV. Njëkohësisht do të sillte edhe kursim në përdorimin e pajisjeve ngritëse për realizimin e skemës.

Kjo aparaturë multifunksionale duhet të sigurojë edhe përparësi të tjera, si më poshtë vijon:

- Të jetë një aparaturë e fuqishme që të sigurojë matje trefazore me  $3 \times >30$  A DC dhe 400 V AC;
- Komandimin automatik të rregullatorit të tensionit në ngarkesë të auto dhe të transformatorëve si dhe testimin e tyre, pa nevojën e pajisjeve shtesë;
- Demagnetizimi i shpejtë dhe i besueshëm i bërthamës së transformatorit, etj.

Disa nga testet që duhet të kryejë kjo aparaturë multifunksionale po i rendisim si më poshtë vijon:

1. Matjen e rezistencave ohmike të pështjellave të autove&transformatorëve të fuqisë me tension të vazhduar DC;
2. Matjet e rezistencës dinamike (DRM). Kjo matje përdoret për të kontrolluar rregullatorin e tensionit në ngarkesë (OLTC) për konstatuar që kontaktet e OLTC janë në gjëndje të mirë teknike dhe të verifikuar në rastin kur kemi dëmtimin e tyre;
3. Matjen e raportit të tensionit (spirave) midis pështjellave të autove&transformatorëve të fuqisë. Të ketë si opsion të saj edhe matjet me tension të rritur, nëpërmjet aksesoreve shtesë si transformator tensioni rritës, etj., që të realizojë kontrollin e mos pasjes së spirave në të shkurtër të pështjellave me tension deri në 12 kV a më shumë. Matjet edhe në këtë rast kryhen me komandim automatik të rregullatorit të tensionit nga aparatura testuese;

- 
4. Kontrollin e grupit të vektorëve (grup lidhjes) të autove&transformatorëve të fuqisë. Kontrolli i grupit vektorial mund të përdoret për të përcaktuar vërtetësinë e grupit vektorial të transformatorit të fuqisë, kur njihet, ose për ta përcaktuar kur nuk njihet paraprakisht;
  5. Matjen e rrymave të eksitimit të autove&transformatorëve të fuqisë. Kjo për të verifikuar gjëndjen e qarkut magnetik, rregullatorin e tensionit, izolacionin midis siprave të pështjellave (nëse kemi lidhje të shkurtër midis tyre, pra dëmtim të izolacionit), etj. Edhe këtë testim aparatura multifunksionale, me ndihmën e aksesorëve ndihmës, mund ta kryej edhe me tension të rritur deri në 10 kV;
  6. Të realizojë testimin për ftohje (të rënjës së temperaturës). Ky test kryhet për të përcaktuar temperaturën e pështjellës në fund të procedurës së testimit të nxehtësisë të autove&transformatorëve të fuqisë me anë të një matjeje të rezistencës ohmike të pështjelljës (DC);
  7. Të kryejmë testimin e tensionit të lidhjes së shkurtër dhe të rezistencës së rrjedhjes. Këto teste janë shumë të rëndësishme për të përcaktuar deformimet apo zhvendosjet e bobinave të autove&transformatorëve të fuqisë.  
Gjithashtu duke përdorur të njëjtën skemë lidhje si në rastin e matjes së tensionit të lidhjes së shkurtër, aparatura me anë të përgjigjes me frekuencë, të mund të indentifikojë lidhjen e shkurtër midis degëve paralele të pëshjellave apo mbinxehjet lokale gjatë kalimit të mbirrymave;
  8. Aparatura duhet të kryej demagnetizimin e qarkut magnetit (bërthamës) të autove dhe të transformatorëve të fuqisë, për shëmbull pas kryerjes së testeve të matjes së rezistencave ohmike me tension DC. Ky proces, demagnetizimi, shërben për të ulur rrezikun e rrymave të larta gjatë energjizimit dhe ndikimet negative në testet e tjera pasardhëse zvogëlohen;
  9. Kjo aparaturë, së bashku me aksesorin e tensionit të lartë, të kryejë matjen e TanDeltës dhe Faktorit të Fuqisë të pështjellave dhe të izolatorëve kalimtarë të autove dhe të transformatorëve të fuqisë;
  10. Apartura duhet të jetë konfiguruar në mënyrë të tillë që të kryejë edhe teste të shpejta. Aparatura të na japë aksesin që ne të mund të përcaktojmë procedurat tona të testimit dhe të përformojmë matje të veçanta si balanca magnetike ose impedanca me sekuencë zero, etj.

Për realizimin e sa më sipër kjo aparaturë duhet të ketë këto konfigurime:

1. Aparatura e mësipërme, për të realizuar testime të autove dhe të transformatorëve të fuqisë, duhet të jetë e kompletuar me kablllo multifunksionale të posaçme. Këto kablllo duhet të relizojnë lidhjen me 4 fije (Kelvin) dhe pas lidhjes se tyre:
  - nga njëra anë, me terminalet e objektit (transformatorin) që do të testohet (terminalet nga ana e tensionit të lartë dhe të mesëm (ose të ulët)) dhe,
  - nga ana tjetër pas lidhjes edhe me aparaturën, të gjitha daljet e provës dhe hyrjet matëse, të kontrollohen automatikisht nga aparatura pa pasur nevojë të ndryshojme përsëri lidhjen për një radhë testesh.Për të kaluar automatikisht midis pozicioneve të ndryshme të rregullatorit të tensionit në ngarkesë (OLTC), duhet që aparatura të jetë e furnizuar me një kablllo me shumë priza. Ky kabëll mund të përdoret gjithashtu për të regjistruar rrymën dhe tensionin e motorit të OLTC.

- 
2. Aparatura duhet të jetë e projektuar sipas një vizatimi kompakt dhe të fuqishëm të pajisur me tre burime të integruara duke na mundësuar të kryejmë matje me saktësi të lartë në një kohë me të shkurtër, krahasuar me aparaturat e tjera, si:
    - > Raporti i spirave të transformatorit 3fazor me 400 V L-L;
    - > Rezistenca e pështjelljellës 3-fazore me rrymë >30 A DC;
    - > Tension të qarkut të shkurtër 3-fazor / reaktanca e rrjedhjes 3-fazore;
    - > Demagnetizimi i shpejtë me rrymë >15 A, etj.
  3. Aparatura e pajisur edhe me transformatorin e tensionit deri në 12 kV, të sigurojë një brez të gjerë testimi me frekuencë të ndryshueshme 15 Hz në 400 Hz;
  4. Aparatura të sigurojë shkarkim aktiv dhe demagnetizim e shpejtë. Ndërsa për demagnetizimin e qarkut magnetik e kemi sqaruar edhe më lart, opsioni i shkarkimit aktiv i kësaj aparture nënkupton shkarkimin automatikisht të pështjelljellës brenda disa sekondave, p.sh. pasi të jenë kryer matjet e rezistencës. Kjo përshpejton kohën e testimit, mbron vetë aparaturën dhe rrit sigurinë për testuesin;
  5. Aparatura të jetë e sigurtë në vetvete dhe të sigurojë së pari sigurinë në punë të personelit që do të kryej testimet me të. Aparatura duhet të përmbush standardet më të larta të sigurisë duke ofruar një buton ndalimi emergjent si dhe sinjalistikën me dritat e sigurisë dhe paralajmëruese. Aksesoret e saj (kabllot) duhet të jenë të pajisura me spina dhe me emërtime përkatëse që të sigurojnë kontrollin e saktësisë së lidhjes së skemës dhe mos të lejojnë të gabosh;
  6. Aparatura duhet të projektohet sipas një vizatimi (dizajni) të fortë dhe kompakt. Aparatura me të gjithë aksesoret përbërës të saj duhet të projektohen që të futen në një valixhe të vetme. E gjithë pajisja duhet të jetë e lehtë në përdorim edhe nga një personel i vetëm në terren dhe si e tillë të mos e kalojë një peshë prej rreth <21 kg. Dizajni i fortë e bën aparaturën të përshtatshme për testimin në vend, si dhe në mjedise (terrene) të vështira.

Aparatura duhet të sigurojë përgatitje të thjeshtë të testit dhe ekzekutim të shpejtë të testit. Për të realizuar këtë, aparatura duhet të funksionojë në disa mënyra, si më poshtë vijon:

- Prodhuesi duhet të furnizojë një program të fuqishëm dhe të posaçëm të menaxhimit të testimeve me aparaturën multifunksionale. Ky program ofron:
  - funksionalitet bazë në laptopin tonë të lidhur me pajisjen
  - një rrjedhë pune të udhëhequr testimi, menaxhim të lehtë të të dhënave dhe vlerësim automatik të rezultateve në laptopin tonë të lidhur me aparaturën;
- Aparatura duhet të jetë pajisur edhe me një ekran me prekje, duke përdorur ekranin e integruar me prekje për rrjedhën e shpejtë dhe të lehtë të punës së testimit në pajisje. Kontrolli me anë të ekranit me prekje nënkupton që aparatura duhet të përmbajë një ekran të integruar, me rezolucion të lartë, me shumë prekje. Duhet të sigurojë kontrast të lartë të ekranit >10” të sigurojë shikueshmëri të mirë edhe në rrezet e forta të diellit. Kjo lejon testim të shpejtë, fleksibël dhe të lehtë pa sjell në vend një kompjuter laptop, pra në përshtatje edhe me terrenet e vështira.

Të tre opsionet mbështesin të gjitha testet diagnostifikuese në transformatorët e fuqisë dhe shpërndarjes.

Aparatura duhet të jetë e pajisur edhe me portë USB-je për marrjen e të dhënave nga aparatura apo për futjen e të dhënave të munshme të programuara paraprakisht në PC.

---

Gjatë testimeve direkt nga ekrani me prekje, aparatura duhet të sigurojë një testim me procedurë të përgatitur të gatshme apo të lejojë përgatitjen e një procedure të personalizuar nga ana e testuesit. Aparatura duhet të mundësojë futjen e parametrave autentike të pajisjes që do të testohet autove&transformatorëve të fuqisë.

Programi i menaxhimit dhe asistimit të testeve, i instaluar në aparaturë dhe laptop, duhet të sigurojë dhe suportoje në mënyrën më të mirë të munshme përgatitjen dhe kryerjen (ekzekutimin) e testeve. Programi duhet të suportoje vendosjen e të gjithë parametrave të objektit që do të testohet, të ofrojë skema mbështetëse të lidhjes së aparaturës me objektin, duke lehtësuar realizimin e skemës dhe shmangur lidhjen e gabuar, pas vendosjes së parametave dhe shtypjes së butonit të ekzekutimit të testimit, më pas të kemi shfaqjen e rezultateve të testimit në formë tabelare dhe grafikësh. Programi të lejojë modifikimin e tabelave për ta bërë më të aksesueshëm krahasimin midis matjeve të fazëve të ndryshme apo midis pozicioneve të ndryshme te rregullatorit të tensionit.

Programi i menaxhimit dhe asistimit të testeve të bëj të mundur:

1. Kryerjen e një testi ose grup testesh. Të lejoj të përcaktosh një grup testesh, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në lidhje. Me klikimin e një butoni, të gjitha testet brenda grupit të ekzekutohen automatikisht në sekuencën e përcaktuar. Kjo redukton kohën e testimit dhe rrit komoditetin;
2. Pas përfundimit të testimit apo grupit të testeve, të realizojë përgatitjen automatike të raportit të testeve dhe ruajtjen, arkivimin automatikisht të tyre. Çdo test mund të vlerësohet automatikisht sipas standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare. Programi të ketë aksesin për të inkorporuar logon e kompanisë tonë, fotot dhe rezultatet e tjera të testimit;
3. Të kryej ruajtjen e të gjitha testeve paraardhëse në arshivë të cilat mund të aksesohen në çdo kohë. Për më tepër, ato mund të krahasohen me rezultatet e mëparshme dhe tendencat historike, duke lejuar analiza të mëtejshme të thelluara;
4. Të lejoj importin e testeve nga një aparaturë e ngjashme dhe krahasimin me testet paraardhëse, etj.

Programi i menaxhimit dhe asistimit të testimeve të ketë aplikacionin përkatës falas në App Store dhe Google Play Store. Me anën e këtij aplikacioni, të instaluar në celular të mbështesë testet në vënd dhe zgjeron funksionalitetin e programit të tilla si: dërgimi i imazheve drejtpërdrejt, mbështet instalime elektrike të shpejta dhe të sigurta për teste, me anë të aksesimit të skemave përkatëse të lidhjes aparaturë objekt testimi në celular, si dhe një buton ndalimi për matjet në proces, etj.

**Të dhënat teknike të aparaturës:**

Të dhënat e parametrave dalës (outputs) nga aparatura:

- Daljet HV dhe LV – të fuqisë:

Frekuenca DC ose 15 Hz ... 599 Hz;

Fuqia	$V_{\text{kryesor}} > 100 V_{\text{RMS}}$	$P_{\text{për 30s}} > 1480 W$	$P_{\text{për kohë të gjatë}} > 990 W$
	$V_{\text{kryesor}} > 190 V_{\text{RMS}}$	$P_{\text{për 30s}} > 3900 W$	$P_{\text{për kohë të gjatë}} > 2400 W$

- Daljet HV dhe LV – të tensionit:

Burimi	Diapazoni	$I_{\max. vazhdueshme}$
3-fazor AC (RMS)	0--230 V (LN)	$\geq 99 \text{ mA}_{\text{RMS}}$
	0--80 V (LN)	$> 15 \text{ A}$
	0--40 V (LN)	$> 30 \text{ A}$
1-fazor AC (RMS)	0--240 V (LN)	$> 15 \text{ A}$
	0--80 V (LN)	$> 30 \text{ A}$
3-fazor DC	0-- $\pm 113 \text{ V}$	$> 15 \text{ A}$
	0 -- $\pm 56 \text{ V}$	$> 30 \text{ A}$
1-fazor DC	0-- $\pm 340 \text{ V}$	$> 15 \text{ A}$
	0 -- $\pm 170 \text{ V}$	$> 30 \text{ A}$

- Daljet HV dhe LV – të rrymës:

Burimi	Diapazoni	$V_{\max. vazhdueshme}$
3-fazor DC	0-- $> \pm 30 \text{ A}$	$\geq 55 \text{ V}$
	0-- $> \pm 15 \text{ A}$	$\geq 110 \text{ V}$
1-fazor DC	0-- $> \pm 100 \text{ A}$	$\geq 55 \text{ V}$
	0-- $> \pm 30 \text{ A}$	$\geq 170 \text{ V}$
	0-- $> \pm 50 \text{ A}$	$\geq 110 \text{ V}$
	0-- $> \pm 15 \text{ A}$	$\geq 340 \text{ V}$
3-fazor AC (RMS)	0--30 A (LN)	$\geq 40 \text{ V}$
	0--15 A (LN)	$\geq 80 \text{ V}$
1-fazor AC (RMS)	0--50 A (LN)	$\geq 80 \text{ V}$
	0--30 A (LN)	$\geq 120 \text{ V}$
	0--15 A (LN)	$\geq 240 \text{ V}$

*Të dhënat e parametrave hyrës (Inputs) nga aparatura:*

- Hyrjet HV & LV – të tensionit:

Hyrja	Diapazoni	Saktësia
AC (RMS)	0--300 mV	$\leq 0.011 \% \text{ lex.} + \leq 0.0032 \% \text{ të diapazonit}$
	0--3 V	$\leq 0.011 \% \text{ lex.} + \leq 0.0032 \% \text{ të diapazonit}$
	0--30 V	$\leq 0.011 \% \text{ lex.} + \leq 0.0032 \% \text{ të diapazonit}$

	0--300 V	$\leq 0.012\%$ lex. + $\leq 0.0032\%$ të diapazonit
DC	0-- $\leq 42.5$ mV	$\leq 0.024\%$ lex. + $\leq 0.0033\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 425$ mV	$\leq 0.0012\%$ lex. + $\leq 0.0018\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 4.25$ V	$\leq 0.008\%$ lex. + $\leq 0.0013\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 42.5$ V	$\leq 0.011\%$ lex. + $\leq 0.0018\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 425$ V	$\leq 0.008\%$ lex. + $\leq 0.0013\%$ të diapazonit

- Hyrjet HV & LV – të rrymës:

Hyrja	Diapazoni	Saktësia
AC (RMS)	0-- $\leq 4.2$ A <sub>RMS</sub>	$\leq 0.038\%$ lex. + $\leq 0.0035\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 42$ A <sub>RMS</sub>	$\leq 0.024\%$ lex. + $\leq 0.0014\%$ të diapazonit
DC	0-- $\leq 0.58$ A <sub>DC</sub>	$\leq 0.12\%$ lex. + $\leq 0.024\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 5.8$ A <sub>DC</sub>	$\leq 0.038\%$ lex. + $\leq 0.0028\%$ të diapazonit
	0-- $\leq 58$ A <sub>DC</sub>	$\leq 0.008\%$ lex. + $\leq 0.0012\%$ të diapazonit

#### Vlerat e kombinuara

##### Matja e rezistencës ohmike DC

Rryma	Diapazoni	Saktësia
3 A <sub>DC</sub>	10-- $\leq 100$ $\Omega$	$\leq 0.11\%$ lex. + $\leq 0.19\%$ të diapazonit
	1-- $\leq 10$ $\Omega$	$\leq 0.11\%$ lex. + $\leq 0.268\%$ të diapazonit
	0.1-- $\leq 1$ $\Omega$	$\leq 0.11\%$ lex. + $\leq 0.19\%$ të diapazonit
30 A <sub>DC</sub>	1-- $\leq 10$ $\Omega$	$\leq 0.038\%$ lex. + $\leq 0.018\%$ të diapazonit
	0.1-- $\leq 1$ $\Omega$	$\leq 0.04\%$ lex. + $\leq 0.028\%$ të diapazonit
	0.01-- $\leq 0.1$ $\Omega$	$\leq 0.033\%$ lex. + $\leq 0.017\%$ të diapazonit
	0.001-- $\leq 0.01$ $\Omega$	$\leq 0.038\%$ lex. + $\leq 0.028\%$ të diapazonit
	0.0001-- $\leq 0.001$ $\Omega$	$\leq 0.05\%$ lex. + $\leq 0.044\%$ të diapazonit
100 A <sub>DC</sub>	3-- $\leq 30$ m $\Omega$	$\leq 0.033\%$ lex. + $\leq 0.017\%$ të diapazonit
	300-- $\leq 3000$ $\mu\Omega$	$\leq 0.037\%$ lex. + $\leq 0.027\%$ të diapazonit
	30-- $\leq 300$ $\mu\Omega$	$\leq 0.052\%$ lex. + $\leq 0.044\%$ të diapazonit
	3-- $\leq 30$ $\mu\Omega$	$\leq 0.07\%$ lex. + $\leq 0.044\%$ të diapazonit

##### Matja e raportit të transformimit (raportit të spirave të pëstjellave)

Diapazoni	Saktësia
1:1-- $\leq 10$	$\leq 0.032\%$ lex. + $\leq 0.044\%$ të diapazonit

1:10-- $\leq 100$	$\leq 0.028$ % lex. + $\leq 0.044$ % të diapazonit
1:100-- $\leq 1000$	$\leq 0.028$ % lex. + $\leq 0.044$ % të diapazonit
1:1000-- $\leq 10000$	$\leq 0.028$ % lex. + $\leq 0.044$ % të diapazonit

Të dhënat e hyrje/dalje për komandimin automatik të rregullatorit të tensionit në ngarkesës (OLTC):

Tensioni 300 V<sub>RMS</sub>

Saktësia AC (50 / 60 Hz) / DC  $\leq 0,075$  % lex. +  $\leq 0,075$  % të diapazonit

Regullatori i tensionit lart/poshtë çelësi Rryma: 300 mA për kohë të gjatë;  $\geq 9$ A për  $\geq 0,6$  sek.

Tensioni: 300 V<sub>RMS</sub>

**Kërkesat e sitemit për të suportuar programi e menaxhimit të testeve (matjeve) dhe asistimit të tyre.**

Kërkesat e sitemit:

Sitemi i operimit: **Windows 10™, 64-bit ose më i fundit;**

CPU: **Sistem me shumë bërthama me 2 GHz ose më i shpejtë**

**(Multicore system with 2 GHz or faster);**

RAM:  **$\geq 8$  GB;**

Hard disk:  **$\geq 5$  GB të hapësirës në dispozicion;**

Storage device: DVD-ROM drive;

Graphics adapter: Super VGA (1280×768) ose përshtatës dhe monitor video me rezolucion më

të lartë (or higher-resolution video adapter and monitor);

Ndërfaqja (Interface): Internet (Ethernet) NIC;

Programet e instaluar (Installed software): Microsoft Office® 365, Office® 2019, Office® 2016 or Office® 2013

*Të dhënat e furnizimit me energji të aparaturës:*

- Tensioni: Nominal:  $\leq 95$  V---  $\geq 240$  V; I lejuar:  $\leq 90$  V---  $\geq 260$  V
- Frekuenca: Nominal: 50/60 Hz; I lejuar: 45---65 Hz;
- Rryma e veprimt të siguresave me hapje automatike të qarkut (stakim të aparaturës) nga mbirrymat magnetike në  $I > 16$  A;
- Konsumi i energjisë: Për punim të vazhdueshem të aparatures:  $\leq 3.525$  kW; Per ngarkesë maksimale:  $\leq 5.25$  kW.

*Të dhëna mekanike:*

Dimensionet (WxHxD):  $\leq 585$  mm( $\leq 465$  mm pa dorezat)x $\leq 390$  mmx230 mm;

Pesha:  $\leq 21$  kg (me ekran me prekje).

*Kushtet mjedisore të punimit dhe ruajtjes së aparaturës:*

- Të punimit:  $\leq -9.8\text{ }^{\circ}\text{C}$ ---  $\geq +54\text{ }^{\circ}\text{C}$ ;
- Të magazinimit (ruajtjes):  $\leq -29\text{ }^{\circ}\text{C}$ ---  $\geq +69\text{ }^{\circ}\text{C}$ ;

Lagështia relative: 5 % ... 95 %, pa kondensim;

Lartësia maksimale:

- E funksionimit:  $\geq 1900\text{ m}$  dhe deri në  $\geq 4900\text{ m}$  (me parametra të reduktuar gjatë testimit);
- E magazinimit:  $\geq 12000\text{ m}$ .

### **Aparatura ngritëse e tensionit deri në 12 kV**

Tensioni i lartë në dalje të aparaturës:

$U = 0$ ---12 kV,

- Për rrymë maksimale:  $I_{\text{max.}} = 300\text{ mA}$ , Fuqia maksimale:  $S_{\text{max.}} \geq 3550\text{ W}$  dhe kohë maksimale :  $t_{\text{max}} > 2\text{ min}$ ;
- Për rrymë maksimale:  $I_{\text{max.}} = 100\text{ mA}$ , Fuqia maksimale:  $S_{\text{max.}} \geq 1180\text{ W}$  dhe kohë maksimale :  $t_{\text{max}} > 60\text{ min}$ ;

Kapaciteti  $C_p$  (qarku paralel ekuivalent):

Diapazoni	Saktësia	Kushtet
1 pF ---3 $\mu\text{F}$	$< 0.055\%$ e lex. + 0.1 pF	$I_x < 8\text{ mA}$ $U_{\text{test}} = 2\text{ kV}$ ---10 kV
1 pF ---3 $\mu\text{F}$	$< 0.21\%$ e lex.	$I_x > 8\text{ mA}$ $U_{\text{test}} = 2\text{ kV}$ ---10 kV

Faktori i fuqisë PF ( $\cos \varphi$ ):

Diapazoni	Saktësia tipike	Kushtet
0--- 10 % (capacitive)	$< 0.11\%$ e lex.+ 0.005 %	$f = 45 \dots 70\text{ Hz}$ , $I < 8\text{ mA}$ $U_{\text{test}} = 2\text{ kV}$ ---10 kV
0--- 100 %	$< 0.52\%$ e lex.+ 0.002 %	$U_{\text{test}} = 2\text{ kV}$ ---10 kV

Faktori i shpërndarjes TanDelta DF ( $\tan \delta$ ):

Diapazoni	Saktësia tipike	Kushtet
0--- 10 % (kapacitive)	$< 0.11\%$ e lex.+ 0.005 %	$f = 45 \dots 70\text{ Hz}$ , $I < 8\text{ mA}$ $U_{\text{test}} = 2\text{ kV}$ ---10 kV
0--- 100 %	$< 0.52\%$ e lex.+ 0.002 %	$U_{\text{test}} = 2\text{ kV}$ ---10 kV:



---

### **Të dhëna të tjera të porosisë:**

Aparatura multifunkionale duhet të ketë të përfshirë në programet e instaluara në të të gjitha licencat e duhura për të kryer të gjitha testet e përhira në specifikimet e mësipërme;

Të ketë të përfshirë programin e menaxhimit dhe asistimit të testeve (matjeve) të përditësuar (të fundit) për instalim në PC me të gjithë komponentet e plotë të tij, për manaxhim, asistim, krahasim, etj;

Përsa i përket aksesoreve:

Furnizimi duhet të përmbajë të gjithë aksesorët e nevojshëm për kryerjen e të gjithë testeve të specifikuara më sipër, përfshirë aparaturën multifunkionale dhe pajisjen ngritëse të tensionit deri në 12 kV. Këtu kemi parasysh të gjithë kabllot e mundshme, morseteritë, pajisjet për tokzim, lidhjen midis aparaturave, aparaturë dhe PC, aparaturë pajisje që do të testohet, etj.

Duhet të kihet parasush që OST sh.a. ka në shfrytëzim auto dhe transformatorë fuqie deri në 345 MVA, tesnionet të larta deri në 400 kV, që nënkupton që kabllot dhe elementet e tjerë duhet të mbulojnë si lartësinë e madhe nga toka (> 10 m) edhe largësinë midis izolatorëve kalimtarë për tensionet 400 kV ( $\geq 5$  m) në aksesorë të përfshihet edhe një karrocë e përshtatshme për testimet me një person në terren ku të montohen edhe aparaturat multifunkionale dhe ngritëse e tensionit për testimin të TanDeltës dhe faktorit të fuqisë. Të përmbajë edhe një platformë për vendosjen e PC.

Në aksesorët të përfshihen edhe të gjitha valixhet për ruajtje dhe transportim të aparaturave dhe aksesoreve të mësipërm me material plastik të fortë mekanikisht dhe me rrota për lëvizje të lehtësuara në terren.

## **2. Aparaturë për Analizën me Përgjigje me Frekuencë (FRA) të autove dhe transformatorëve të fuqisë.**

Qëllimi bazë i kësaj aparature është që të identifikojë çdo problem mekanik apo elektrik në përshtjetat, kontaktet apo qarkun magnetik të autove dhe transformatorëve të fuqisë.

Kjo aparaturë testimi konsiston, si parim pune, në injektimin e valëve (sinjalit) me frekuencë të ndryshueshme në një gamë (diapason) të gjërë nga njëra anë e auto apo transformatorit, për shembull në terminalet e tensionit të lartë, dhe marrja e përgjigjes së sinjalit në anën tjetër, për shembull në terminalet e tensionit të ulët në formën e kurbave (grafikeve).

Transformatorët e fuqisë mund të shihen si një rrjet kompleks elektrik i kapaciteteve, induktancave dhe rezistencave. Çdo rrjet elektrik ka përgjigjen e tij unike të frekuencës (të ashtuquajturat "gjurmë gishtash") dhe në ratin tonë këto kurba (grafike) të përfutuara janë unike për çdo pajisje transformuese dhe shërben si një fingerprint për auton apo transformatorin e fuqisë.

Mjafton që ky test të realizohet fillimisht (më e mira e mundshme) që në testet e prodhimit të auto apo transformatorit të fuqisë, në pamundësi të kryhet për çdo auto apo transformator fuqie që është në shfrytëzim brenda kushteve teknike. Pas çdo transportimi, lidhje të shkurtër apo procesi kalimtarë, tërmeti të fuqishëm, etj., të rikryhet ky testim dhe duke bërë krahasimin e të dhënave, grafikëve (kurbave) për konfigurime të njëjta të skemës së testimit dhe pozicioneve të rregullatorit, të kemi një gjykim që të na tregojë që pajisja transformuese

---

nuk/ka pasur ndryshim gjeometrik të pjesës aktive (pështjellave apo/edhe qarkut magnetik), dëmtim të kontakteve, etj.

Me fjalë të tjera çdo ndryshim konstruktiv në pjesën aktive (që mund të shihet si një ndryshim i kapaciteteve, induktancave dhe rezistencave të tij) sjell një deformim (devijim) të kurbave të përftuara krahasuar me kurbat para ndryshimit konstruktiv.

Pra në thelb, duke përdorur aparaturë me përgjigje me frekuencë, mund të zbulojmë dëmtime si defekte në bërthamën magnetike, montimin e mbështjelljes dhe strukturat shtrënguese të transformatorëve të fuqisë, si p.sh.:

- Deformimi i pështjellës aksiale apo/edhe radiale;
- Zhvendosjet ndërmjet pështjelljeve të tensionit të lartë dhe të ulët apo kundrejt qarkut magnetik;
- Deformim i pjesshëm i pështjellës;
- Spira në të shkurtër ose të hapura;
- Rënje me tokëzimin e qarkut magnetik ose/edhe ekraneve;
- Lëvizje të gjeometrisë së qarkut magnetik, thuprave apo zgjedhës së poshtme apo të sipërme;
- Dëmtim apo/edhe hapje të strukturave shtrënguese të nuklit apo pështjellave;
- Lidhjet e brendshme problematike, etj.

Si rezultat i këtij diagnostifikimi ne të mund të përmirësojmë besueshmërinë e gjëndjes teknike të autove apo transformatorëve të OST sh.a., të zvogëlojmë kostot e mirëmbajtjes dhe, mbi të gjitha, të shmangim ndërprerjet e papritura dhe të shtrenjta të energjisë.

Aparatura e mësipërme e analizës me përgjigje me frekuencë duhet të sigurojë, me anën e aksesorëve të saj, lidhjet perfekte ndërmjet pajisjes matëse dhe terminaleve të transformatorit, zgjidhjet teknike të tokëzimit, të gjitha këto kanë një ndikim në riprodhueshmërinë e matjeve (kurbave) të sakta.

Aparatura të jetë e pajisur me aksesorë, si:

- kapse, të projektuara posaçërisht që të sigurojnë një kontak shumë të mirë me daljet e terminaleve nga izolatorët kalimtar të pajisjeve transformuese;
- kablllo fleksibël terminale-apaturë të cilat të sigurojnë raportin më të lartë të disponueshëm sinjal-zhurmë, të përdoren kablllo me dy mburojë me boshtin, të cilët duhet të tokëzohen me një lidhje shtesë sipas konventave të çaktuara;
- tokzimi terminal izolatori me tokën të kryhet me shirit tokëzimi në formën e “gërshetave” të gjëra të sheshta të dedikuara për këtë proces. Ato duhet të ofrojnë një sipërfaqe të madhe, induktivitet më të ulët dhe janë më pak të ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve të fushave të jashtme. Kjo e bën matjen të pavarur nga pozicioni i kabllit dhe rrit ndjeshëm nivelin e riprodhueshmërisë veçanërisht në zonën e diapazonit të frekuencës së lartë. Për të eliminuar çdo ndikim të sistemit të tokëzimit në rezultatet tuaja të matjes, gërshetat e tokëzimit duhet të konstruktohen që të qëndrojnë gjithmonë fort përgjatë trupit të izolatoreve kalimtarë. Kjo sigurohet nga kapëset e vidave me fllanxha të projektuara posaçërisht dhe gjatësia e gërshetave të tokëzimit fleksibël që përdoren.

---

Theksojmë që gjatësia e shiritave të tokëzimit duhet të jetë e mjaftueshme për të kryer tokëzimin e izolatorëve kalimtar të anës 400 kV të autove dhe transformatorëve të OST sh.a.

Pas testeve me anë të aparaturës së analizimit me përgjigje me frekuencë dhe pas verifikimit të ndryshimeve në këtë përgjigje shkohet në një diagnostifikim më të thelluar duke zbatuar teste specifike me aparatura të tjera.

Aparatura e analizimit me përgjigje me frekuencë duhet të sigurojë këto karakteristika:

- diapozon dinamik të lartë të matjes dhe saktësie të lartë. Aparatura duhet të sigurojë një procedurë inovative të matjes dhe testet (matjet) duhet të kryhen me saktësi të lartë prej  $\pm \leq 0,5$  dB deri në -100 dB;
- tension i ndryshueshëm në dalje, pra të sigurojë një tension dalës të rregullueshëm lirisht nga  $\leq 0,1$  Vpp në  $\geq 10$  Vpp (në 50  $\Omega$ ).  
Kështu, rezultatet e matjeve të mëparshme me pajisje të tjera testuese me analizë me përgjigje me frekuencë, mund të krahasohen lehtësisht me matjet e reja;
- programimi të sigurojë fillimisht kryerjen e një matje me brez të gjerë dhe më pas fokusohet në zonat kritike të frekuencës, duke arritur rezultate më të sakta të matjes;
- programi i aplikuar në aparaturë të kryej verifikimin e konfigurimit të saktë të skemës së testimit dhe dedektojë që shiritat e tokëzimit të jenë lidhur siç duhet dhe në rast të kundër (të lidhjes së gabuar të skemës apo tokëzimit) të japë vlerësimin përkatës dhe të mos lejojë vazhdimin e testit, etj.

***Në aparaturën e analizimit me përgjigje me frekuencë duhet të jetë i instaluar një program i menaxhimit dhe asistimit të testeve i përparuar dhe funksional.***

*Programi i menaxhimit dhe asistimit të testeve, i instaluar në aparaturë dhe laptop, duhet të sigurojë suportojë në mënyrën më të mirë përgatitjen dhe kryerjen (ekzekutimin) e testeve.*

*Programi i menaxhimit dhe asistimit të testeve (matjeve) të bëjë të mundur:*

1. Programi duhet të suportojë vendosjen e të gjithë parametrave të objektit që do të testohet, të ofrojë skema mbështetëse të lidhjes së aparaturës me objektin, duke lehtësuar realizimin e skemës dhe shmangur lidhjen e gabuar, pas vendosjes së parametave dhe shtypjes së butonit të ekzekutimit të testimit, me pas të kemi shfaqjen e rezultateve të testimit në formë tabelare dhe grafikësh. Programi të lejojë modifikimin e tabelave/grafikëve për ta bërë më të aksesueshem krahasimin midis matjeve të fazëve të ndryshme apo midis pozicioneve të ndryshme të rregullatorit të tensionit;
2. Pas përfundimit të testimit apo grupit të testeve, të sigurojë përgatitjen automatike të raportit të testeve dhe ruajtjen, arkivimin automatikisht të tyre. Çdo test mund të vlerësohet automatikisht sipas standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare. Programi të ketë aksesin për të inkorporuar logon e kompanisë tonë, fotot dhe rezultatet e tjera të testimit. Përveç kësaj, të dhënat mund të filtrohen ose eksportohen në formate të zakonshme si XML, PDF, Microsoft Word, Microsoft Excel;
3. Aparatura e analizimit me përgjigje me frekuencë dhe programi i menaxhimit dhe asistimit të testeve (matjeve) do të thotë të jesh në përputhje me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare të zbatueshme IEC dhe IEEE (IEC 60076-18 dhe IEEE C57.149-2012), duke e ulur kohën e testimit;

4. Të kryej ruajtjen e të gjitha testeve paraardhëse në arshivë të cilat mund të aksesohen në çdo kohë. Për më tepër, ato mund të krahasohen me rezultatet e mëparshme dhe tendencat historike, duke lejuar analiza të mëtejshme të thelluara;
5. Të lejojë importin e testeve nga një aparaturë e ngjashme dhe krahasimin me testet paraardhëse, etj.

Programi i menaxhimit dhe asistimit të testimeve të ketë aplikacionin përkatës falas në App Store dhe Google Play Store. Me anën e këtij aplikacioni, të instaluar në celular të mbështesë testet në vënd dhe zgjeron funksionalitetin e programit të tilla si: dërgimi i imazheve drejtpërdrejt, mbështet instalime elektrike të shpejta dhe të sigurta për teste, me anë të aksesimit të skemave përkatëse të lidhjes aparaturë objekt testimi në celular, si dhe një buton ndalimi për matjet në proces, etj.

### **Të dhënat teknike të aparaturës:**

#### **Të përgjithshme:**

- Diapazoni (brezi) i rezistencave: 1 Hz ... 30 MHz.

#### **Të dhënat e parametrave dalës (outputs) nga aparatura:**

- Impedanca (rezistenca e plotë) e daljes (për  $f = 20 \text{ Hz} \dots 2 \text{ MHz}$ ):  $50 \Omega (\pm 2\%)$ ;
- Lidhës (bashkuesi) tip: BNC;
- Amplituda e tensionit:  $\geq 10 \text{ Vpp}$  (në  $50 \Omega$ );
- Diapazoni dinamik (për  $f = 20 \text{ Hz} \dots 2 \text{ MHz}$ ):  $> 150 \text{ dB}$  ( $+10 \text{ dB} \dots -140 \text{ dB}$  "dysHEMEJA" e poshtme e zhurmës<sub>RMS</sub>);

#### **Niveli i saktësisë:**

- Saktësia tipike:  $\leq \pm 0,11 \text{ dB}$  (deri në  $-50 \text{ dB}$ )  
dhe  $\leq \pm 0,32 \text{ dB}$  (midis  $-50 \text{ dB}$  dhe  $-100 \text{ dB}$ );
- Saktësia e garantuar:  $\leq \pm 0,32 \text{ dB}$  (deri në  $-50 \text{ dB}$ )  
Dhe  $\leq \pm 0,52 \text{ dB}$  (midis  $-50 \text{ dB}$  dhe  $-100 \text{ dB}$ ).

### **Kërkesat e sitemit për të suportuar programin e menaxhimit të testeve (matjeve) dhe asistimit të tyre.**

Kërkesat e sitemit:

Sitemi i operimit: **Windows 10™, 64-bit ose më i fundit;**

CPU: **Sistem me shumë bërthama me  $\geq 2 \text{ GHz}$  ose më i shpejtë**

**(Multicore system with 2 GHz or faster);**

RAM:  **$\geq 8 \text{ GB}$ ;**

Hard disk:  **$\geq 5 \text{ GB}$  të hapësirës në dispozicion;**

Storage device: DVD-ROM drive;

---

Graphics adapter: Super VGA (1280×768) ose përshtatës dhe monitor video me rezolucion më

të lartë (or higher-resolution video adapter and monitor);

Ndërfaqja (Interface): USB 2.0, Internet (Ethernet) NIC;

Programet e instaluar (Installed software): Microsoft Office® 365, Office® 2019, Office® 2016 etj.

**Shënim: Marrë parasysh sa më sipër, PC (laptopi) i furnizuar me aparaturën duhet të ketë edhe këto karakteristika minimale:**

Sitemi i operimit: Windows 10™, 64-bit ose më i fundit;

CPU: Sistem me shumë bërthama me  $\geq 2$  GHz ose më i shpejtë  
(Multicore system with 2 GHz or faster);

RAM:  $\geq 16$  GB;

Hard disk:  $\geq 500$  GB;

Storage device: DVD-ROM drive;

Madhësia e ekranit:  $\geq 15$ " (15 inc);

**Portat e pështatshme për lidhjen me aparaturat.**

**Të ketë të instaluar versionin më të fundit të programeve të menxhimit dhe asistimit të testeve të licensuar dhe përditësuar dhe me të gjitha kartat e testeve të përcaktuara në këto specifikime, gjithashtu të licensuara dhe të përditësuara, për të treja pajisjet e specifikuara në këto specifikime.**

***Të dhëna të tjera për aparaturën e anlizimit me përgjigje me frekuencë:***

*Të dhëna mekanike:*

Dimensionet (WxHxD):  $\leq 255$  mmx $\leq 55$  mmx270 mm;

Pesha:  $\leq 2$  kg (pa aksesoret).

*Kushtet mjedisore të punimit dhe ruajtjes së aparaturës:*

- Të punimit:  $\leq -9.8$  °C ---  $\geq +54$  °C;
- Të magazinimit (ruajtjes):  $\leq -32$  °C ---  $\geq +54$  °C;
- Lagështia relative: 20 % --- 95 %, pa kondensim;

**Të dhëna të tjera të porosisë:**

Aparatura e anlizimit me përgjigje me frekuencë duhet të ketë të përfshirë të gjitha paketat që me këtë aparaturë të kryhen testet standarde dhe të shpejta;

Përsa i përket aksesoreve:

Furnizimi duhet të përmbajë të gjithë aksesoret e nevojshëm për kryerjen e testeve të specifikuara më sipër. Këtu kemi parasysh të gjithë kabllot e mundshme, morseteritë, pajisjet për tokzim, lidhjen midis aparaturave, aparaturë dhe PC, aparaturë pajisje që do të testohet, etj.

---

Duhet të kihet parasysh që OST sh.a. ka në shfrytëzim auto dhe transformatorë fuqie deri në 345 MVA, tesnione të larta deri në 400 kV, që nënkupton që kabllot dhe elementet e tjera duhet të mbulojnë si lartësinë e madhe nga toka (> 10 m).

Gjithashtu në set duhet të parashikohen:

- edhe shiritat e tokzimit, morseteritë, etj., për izolatorët e tensioneve të ulta (të shkurtër);
- të gjithë aksesorët për testimin e shpejtë me një çantë transportimi.

Për aparaturën bazë dhe të gjithë aksesorët për teste standarde të paketohen të gjitha në një valixhe plastike me material plastik, konstruktivisht të fortë nga ana mekanike, dhe të pajisur me rrota për transport të lehtësuar edhe në terrene të vështira.

### **3. Aparatura për matjen e temperaturave të kontakteve dhe analizën me imazh termik të auto dhe transformatorëve dhe pikave të nxehta në pajisjet e tjera primare.**

Qëllimi bazë i kësaj aparature (kamere me imazh termik) është që të indentifikojë çdo problem termik, të lidhur me problemet në kontaktet e fuqisë të terminaleve, aksesorët, kazanit kryesor të autove dhe transformatorëve të fuqisë nëpërmjet matjes së temperaturave pik apo duke analizuar imazhet termike të përgjithshme të këtyre pajisjeve transformuese në veçanti dhe pajisjeve primare në përgjithësi.

Të dizajnuara në mënyrë optimale, kamera me imazh termik, duhet të jetë në përditësim të vazhdueshëm për të rritur efikasitetin përmes avancimeve më të fundit të teknologjisë termografike.

Aparatura duhet të ofrojë gjithçka që nevojitet që në mënyrë të sigurtë, të shpejtë dhe të lehtë të gjejmë, vlerësojmë dhe zgjidhim problemet kritike për pajisjen (transformuese apo primare) përpara se ato të rezultojnë në ndërprerje të punës së pajisjeve, të bëhen të kushtueshme ndërhyrjet për rikthimin në gjëndjen e mëparshme teknike apo edhe përfundimet katastrofike.

Aparatura duhet të sigurojë:

- Imazhet në fokus në pak sekonda. Kamera duhet të sigurojë Auto Fokus duke përdorur një matës të integruar të distancës lazer që llogarit dhe shfaq distancën nga objektivi juaj i caktuar dhe rregullon menjëherë fokusin;
- Të jetë optika më e mirë për të transmetuar energji dhe për të prodhuar imazhe infra të kuqe me cilësi të lartë.
- Aparatura të përdor vetëm lente germanium 100% (diamond-turned germanium) me veshje speciale;
- Aparatura të sigurojë shikimin e më shumë detajeve të objektit duke rregulluar nivelin e dritës infra të kuqe dhe të dukshme me teknologjinë e patentuar IR-Fusion;
- Të sigurojë marrjen e imazheve afër dhe larg, në varësi të mundësisë. Lentet inteligjente të këmbyeshme duhet të mos kërkojnë kalibrim dhe të sigurojnë

---

shkathësinë dhe cilësinë e imazhit të nevojshëm për të kryer inspektime në pothuajse çdo mjedis;

- Aparatura të na lejojë të ndryshojmë dhe analizojmë imazhet në kamerë si:
  - të mundet të kryejmë ndryshimin e emetimit;
  - të aktivizojë alarmet me ngjyra dhe shënuesit dhe rregullojë përzierjen e imazheve vizuale dhe infra të kuqe IR-Fusion, etj.
- Të na mundësojë menaxhimin e të dhënave, të kapë matje të shumta (mekanike, elektrike dhe termike) dhe mundësojë organizimin në bazë të programit të instaluar (softuerit);

Programi i instaluar në këtë aparaturë duhet të jetë i fuqishëm dhe, ndërkohë, i lehtë në përdorim.

Ky program softuerik të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfaqësojë të ardhmen e mirëmbajtjes, monitorimit, analizës dhe raportimit të pajisjeve të integruara. Të bëjë sa më të lehtë të optimizosh imazhet termike, të kryejmë analitikë, të gjenerosh raporte të shpejta, të personalizueshme, të fuqishme dhe të eksportosh imazhe në formatin e zgjedhur nga ne.

Ky program të sigurojë:

- Navigim intuitiv, të jetë i lehtë për t'u mësuar dhe i lehtë dhe i shpejtë për të punuar;
- Të siguroj rrjedhë pune të thjeshtuar të raportimit dhe modele të gatshme të raporteve, etj.

### **Të dhënat teknike të aparaturës:**

#### Të përgjithshme:

- Temperatura e punimit (operimit):  $\leq -9$  °C deri në  $\geq +50$  °C;
- Temperatura e magazinimit (ruajtjes):  $\leq -18$  °C deri në  $\geq +50$  °C;
- Lagështia relative: 20 % deri në 95 %, pa kondensim;
- Alarmet sipas ngjyrës (pra edhe sipas temperaturës): Temperatura e lartë, temperatura e ulët dhe izotermat (brenda intervalit);
- Brezi spektral infra të kuqe:  $\leq 7,6$   $\mu\text{m}$  deri në  $\geq 13,9$   $\mu\text{m}$  (valë e gjatë);
- Permasat:  $\leq 28$  cm x  $\leq 12,5$  cm x  $\leq 17$  cm;
- Pesha:  $\leq 1,1$  kg;

#### Të tjera të rëndësishme:

- Gama e matjes së temperaturës :  $\leq -19$  °C deri në  $\geq +999$  °C (jo kalibruar më poshtë  $\leq -10$  °C)
- Saktësia në matje:  $\leq \pm 2$  °C ose  $\leq 2$  %;
- Të ketë mundësi korigjimi të emërimit në ekran;
- Rezolucioni infrared:  $\geq 630$  x  $\geq 470$  ( $\geq 296100$  piksel);
- Të ketë Rezolucion shumë të madhe, mbeshtetur nga programi (softueri). Të kapë dhe kombinoj 4 herë të dhënat për të krijuar një imazh 1280 x 960;
- Distanca minimale në të cilën aparatura duhet të fokusohet:  $\leq 16$  cm;
- Fokus shumë i mprehtë: Po, i fokusuar afër dhe larg, në të gjithë fushën e shikimit;
- Fokus automatik LaserSharp: Po, për imazhe vazhdimisht në fokus. Çdo njësi kohe;

- Të ketë matës të distancës me lazer, të llogarisë distancën nga objektivi për imazhe të fokusuara saktësisht dhe të shfaqë distancën në ekran;
- Fusha e pamjes (këndi): 34 °Horizontal x 24 °Vertikal;
- Fokus manual të avancuar;
- Kamera të jetë me teknologjinë IR-Fusion;
- Ekрани i kamerës të jetë i fortë dhe me prekje me madhësi:  $\geq 3,45$  inç (peisazh), LCD;
- Ndjeshmëria termike:  $\leq 0,052$  °C ( $\leq 50$  mK) në temperaturën e synuar 30 °C;
- Kamera të ketë mundësin për ndërrim të shpejtë automatik midis modaliteteve manuale dhe automatike;
- Zmadhimi dixhital:  $\geq 2x$  dhe  $\geq 4x$ ;
- Kamera dixhitale e integruar  $\geq 4.8$  MP;
- Të ketë tregues lazer (rreze treguese);
- Të ketë dritë LED (“elektrik”) ndriçues, etj.

#### Ruajtja e të dhënave dhe kapja e imazheve:

- Kamera të ketë disa opsione me kapacitete të gjëra memorie, si: memorie flash e brendshme 4 GB, kartë memorie micro SD e lëvizshme 4 GB, aftësia e shkarkimit në USB, etj.;
- Kamera të sigurojë kapjen e imazhit, rishikimit, ruajtjen e imazheve;
- Kamera të sigurojë regjistrim të videos dhe formatet standard dhe radiometrik;
- Të lejojë regjistrimin e shënimit zanor gjatë matjes, koha maksimale e regjistrimit  $\geq 58$  sekonda për imazh;

#### Programi i kamerës me infra red me imazh termik:

- Programi i aparaturës të ketë aplikacion edhe për smartfonin, që pas instalimit të tij të mund të lidhim kamerën me telefonin inteligjent dhe imazhet e marra të ngarkohen automatikisht në aplikacionin për t'i ruajtur dhe ndarë;
- Programim sipas objekteve që testohen: Përmes desktopit, të mund të caktojmë imazhe të objekteve, të kryejmë krahasimin me lehtësi të matjeve të të njëjtit tip në një pajisje që kontrollohet dhe të krijojmë raporte;
- Kamera të ketë lidhje me valë (Wireless) interneti për PC, Android™ 4.3 e lart dhe WiFi në LAN (kur disponohet), etj.;
- Programi (Softueri) duhet të jetë i plotë, i analizës dhe raportimit, me akses dhe i përditësuar, më i fundit;
- Programi të sigurojë analizimin dhe ruajtjen e të dhënave radiometrike në një PC;
- Aparatura të ketë operacionet e komandimit në distancë përmes programit të posaçëm;

#### Të dhëna të tjera të porosisë:

- Aparatura (kamera) të jetë e paketuar me të gjithë aksesorët e saj në një kuti të fortë plastike për mbrojtje dhe transport;
- Të ketë dy bateri inteligjente me jon litium me ekran LED me disa tregues të nivelit të karikimit;
- Karikues AC me energji, për furnizim e baterive, të përfshirë (100 V AC në 240 V AC, 50/60 Hz);
- Përshtatës opsional i karikimit 12 V nga automobili, etj.
- Në paketim të ketë të përfshirë të gjithë aksesorët maksimal që shoqërojnë aparaturën.



---

#### **4. Trajnim për specialistët e DSHMT për pajisjet e reja për matje pajisjesh primare dhe sekondare.**

Qëllimi bazë i këtij trajnimi është që personeli OST sh.a. të aftësohet në përdorimin e aparaturave të reja të përfshira në këto specifikime dhe të tjera, përfshirë njohjen dhe familjarizimin me programet përkatëse të menaxhimit dhe asistimit të testeve, për testimet e plota (diagnostifikimin) të pajisjeve transformuese në veçanti dhe pajisjeve primare në përgjithësi.

Objektivat bazë të këtij trajnimi do të jenë:

1. Diagnostifikimi i auto dhe transformatorëve të fuqisë që kanë të përfshirë rregullatorin e tensionit në ngarkesë:
  - Testimin me aparaturën multifunkionale trefazore të specifikuar në pikën “1” të këtyre specifikimeve. Kryerja e të gjitha testeve nga ekрани me perkje dhe nga PC duke u familjarizuar me programin përkatës të menaxhimit dhe asistimit të testeve. Përgatitja e raporteve teknike pas testeve;
  - Testimin me aparaturën për Analizën me Përgjigje me Frekuencë (FRA) të specifikuar në pikën “2” të këtyre specifikimeve. Kryerja e të gjitha testeve nga PC duke u familjarizuar me programin përkatës të menaxhimit dhe asistimit të testeve. Përgatitja e raporteve teknike pas testeve.
2. Trajnim për testimin e pajisjeve primare, përfshirë transformator rryme dhe tensioni dhe të çelsave:
3. Grupet e punës do të jenë të hapura edhe për prezantime të produkteve të reja, por jo kundrejt shpenzimeve të OST sh.a.

Trajnimet e mësipërme do të kryehen për grupe pune deri në 4 (katër) specialistë të OST sh.a. dhe për një periudhë prej 4 ditë pune. Të gjitha shpenzimet për trajnimin, akomodimin, djetat ditore dhe transportin do të mbulohen nga kontraktori.

Kushtet në të cilat duhet të kryhet trajnimi.

Laboraret e trajnimit të jenë pjesë e fabrikave të prodhimit të aparaturave të specifikuara në pikën “1” dhe “2” të këtyre specifikimeve.

Laboratorët e trajnimit të përmbajnë:

1. Objekte reale të testimit si:
  - Transformator fuqie tre fazor me rregullator tensioni në ngarkesë;
  - Transformator rryme dhe tensioni;
  - Çelës tre fazor fuqije bashkë me panelin përkatës të komandimit, etj.
2. Të gjithë aparaturat e përfshira në këto specifikime trajnimi të jenë pjesë e laboratorit ku do të kryhet trajnimi;

Trajnimi për aparaturarën e specifikuar në pikën “3” të këtyre specifikimeve mund të kryhet në ambientet apo objektet (Nënstationet) e OST sh.a.

Garancia e mirë funksionimit të aparaturave të testimit të specifikuara duhet të jetë të minimalisht 2 (dy) vite.

Për të gjitha aparaturat e testimit të specifikuara duhet të dorëzohen certifikatat e kalibrimin të tyre.

Tabelë përmbledhëse:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Aparaturë komplete multifunksionale për matjen e auto dhe transformatorëve të fuqisë trefazor e pajisur edhe me transformator tensionin për teste në tension të rritur.	Komplet	1
2	Aparaturë për Analizën me Përgjigje me Frekuencë (FRA) të autove dhe transformatorëve të fuqisë.	Komplet	1
3	Aparatura për matjen e temperaturave të kontakteve dhe analizën me imazh termik të auto dhe transformatorëve dhe pikave të nxehta në pajisjet e tjera primare.	Komplet	1
4	Trajnim për specialistët e DSHMT për pajisjet e reja për matje pajisjesh primare dhe sekondare. Grupe pune 2 (dy), sejcili grup pune nga 4 punonjës dhe 4 ditë pune trajnim.	Komplet	1

**Shënime:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njesia	Sasia
1	Aparaturë komplete multifunksionale për matjen e auto dhe transformatorëve të fuqisë trefazor e pajisur edhe me transformator tensionin për teste në tension të rritur.	Komplet	1
2	Aparaturë për Analizën me Përgjigje me Frekuencë (FRA) të autove dhe transformatorëve të fuqisë.	Komplet	1
3	Aparatura për matjen e temperaturave të kontakteve dhe analizën me imazh termik të auto dhe transformatorëve dhe pikave të nxehta në pajisjet e tjera primare.	Komplet	1
